

Bislimi mohon se institucionet shëndetësore ilegale në veri janë target



Faqe 3

Izraeli nis ofensivën tokësore në qytetin e Gazës, të paktën 40 të vdekur




Faqe 6

Zymi si potencial i turizmit kulturor, pret plan menaxhimi



Faqe 11

Zhegrova debuton në spektaklin me plot tetë gola



Faqe 16

e mërkurë • 17 shtator 2025

Numri 10127

KOHA

DITORE

www.koha.net



ISH-NDIHMËSI I SEKRETARIT AMERIKAN TË SHTETIT, JAMES RUBIN, E VAZHDON PËR TË DYTËN DITË DËSHMINË NË HAGË

Rubin: Demaçi ishte epror i Thaçit

Gjatë dëshmisë para Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë, James Rubin e ka përshkruar me shumë ndikim rolin që Adem Demaçi e ka pasur te delegacioni i UÇK-së. Në një moment, ai e ka cilësuar atë edhe si epror të Hashim Thaçit

Ardit Kika

PRISHTINË, 16 SHTATOR – Në ditën e dytë të dëshmisë, në gjykimin më të madh të Speciales, ish-ndihmësi i sekretarit amerikan të Shtetit, James Rubin, ka insistuar se Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) nuk ka pasur strukturë komanduese. Ish-këshilltari i lartë në Departamentin Amerikan të Shtetit (DASH) ka theksuar se edhe Hashim Thaçi është ndikuar nga qëndrimet e Adem Demaçit.

Teksa të martën u është përgjigjur pyetjeve të gjyqtarit Christoph Barthe, Rubini ka thënë se pasi në Rambulliet delegacioni i Kosovës nuk e ka pranuar marrëveshjen, sekretarja amerikane e shtetit, Madeleine Albright, ka realizuar një telefonatë me Demaçin.

“Thaçi kishte nevojë që Demaçi të thoshte që ta shtyjme pak më vonë çështjen e pavarësisë. Prandaj zoti Demaçi ishte eprori i tij nga vendimarrja në këtë grup. Ai kishte nevojë për mbështetje ideologjike nga themeluesi apo personi kryesor ideologjik”, ka theksuar Rubini.

Mbrojtja e Thaçit dhe të tjerëve ka insistuar se Demaçi, i cili e ka drejtuar Zyrën e UÇK-së në Prishtinë, ka qenë figura kryesore e gueriles.

Rubini ka theksuar se edhe në Rambulliet, Thaçi vazhdimisht është konsultuar me Demaçin, i cili ka qenë kundër nënshkrimit të marrëveshjes. Ai ka thënë se roli i Demaçit është relativizuar pasi që ai është dorëhequr, në shenjë pakënaqësie me pranimin e marrëveshjes nga ana e Thaçit.

“Ne të gjithë u kthëm përsëri në Rambuje dhe të gjithë informacionin e diskutuam. Mendoj që dikush më ka thënë, dikush të cilit ia kam dëgjuar fjalën ose dikush me kompetencë, ose më ka thënë Thaçi ose dikush nga

ambasada, pra më është thënë apo të paktën unë kam besuar se Adem Demaçi nuk ishte më lojtar aktiv pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Rambulliet. Me fjalë të tjera është anashkaluar, ka theksuar Rubini.

Në ditën e dytë të dëshmisë, Rubini ka thënë po ashtu se nuk ka parë asnjëherë Shtab të Përgjithshëm të UÇK-së, porse në malet e Berishës e ka parë një tendë me disa karrige dhe Thaçin për tri ditë me radhë tek u bindej komandantëve që kanë qenë të pranishëm. “Unë nuk kam parë asgjë në Kosovë që i përngjante Shtabit të Përgjithshëm. Nuk ka pasur ndonjë shtab për gjeneralët në kontekstin e Kosovës. Unë s’kam parë ndonjëherë gjeneral. Unë s’kam parë ndonjëherë Shtab të Përgjithshëm të gjeneralëve”, është shprehur ai. Ish-diplomati amerikan, i cili është dëshmitar i mbrojtjes, u është përgjigjur edhe pyetjeve të prokurorëve përkitazi me ngjarje që janë të përfshira në aktakuzë, por disa herë ka thënë se ato nuk i kujtohen. Prokurori James Pace e ka pyetur për qëndrimin e tij lidhur me Gjykatën Speciale. Rubini ka thënë se procesi ndaj Thaçit dhe të tjerëve është padrejtësi.

“Fakti që të akuzuarit janë në burg për më shumë se pesë vjet dhe janë dorëzuar vullnetarisht dhe fakti që janë mbajtur të ndaluar për kaq shumë gjatë më shqetëson. Mendoj që lidhet me politikën dhe shtetin e së drejtës dhe mua më shqetëson fakti që dikush të jetë i paraburgosur për pesë vjet përpara se të ndiqet penalisht një çështje penale, ndërkohë që këta persona janë dorëzuar vullnetarisht dhe kanë qenë shumë bashkëpunues me gjykatën. Kështu që në rastin e të akuzuarit në fjalë nuk e kuptoj fare se pse është dashur të qëndrojnë në burg për pesë vjet”, ka thënë ai.



Foto: Driton Paçarada

Prishtinë, 16 shtator - Ministria e Punëve të Jashtme të Finlandës, Elina Valtonen, e cila është edhe kryesuese e OSBE-së, ka thënë se Kuvendi nuk është konstituuar konform Kushtetutës së Kosovës. Në një konferencë për media, të martën në Prishtinë, ajo ka bërë thirrje që institucionet e reja të formohen sa më shpejt. Gjatë qëndrimit në Kosovë, ajo ka takuar presidenten Vjosa Osmani, por jo edhe kryeministrin në detyrë, Albin Kurti, dhe homologen e saj, Donika Gërvalla

TË MARTËN NË GJYKATËN THEMELORE NË PRISHTINË ËSHTË MBAJTUR SEANCË FILLESTARE PËR RASTIN NDAJ TË PANDEHURËS JELENA GJUKANOVIQ

Punonjësja e OSBE-së deklarohet e pafajshme në akuzën për spiunazh

Donisa Fazliu

PRISHTINË, 16 SHTATOR – Punonjësja e misionit të OSBE-së në Kosovë, e akuzuar si spiune e Serbisë, Jelena Gjukanoviq, është deklaruar e pafajshme në seancën fillestare të mbajtur të martën në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

“E pafajshme”, ka thënë ajo. Prokuroria Speciale e akuzon atë se ka kryer veprën penale deri në momentin e arrestimit të saj, në shkurt të këtij viti. Sipas aktakuzës, Gjukanoviq si zyrtare e misionit të OSBE-së në Kosovë me vetëdije të plotë ka kryer veprime të përsëritura duke përcjellë informacione të dokumentuara për agjentin rezident të BIA-së, Alek-

sander Vllajiq, të cilat informacione pastaj janë transmetuar te zyrtarët e lartë të BIA-së.

“Gjatë ushtrimit të detyrës së saj zyrtare në kuadër të aktivitetit të misionit të OSBE-së, ndihmë kjo e realizuar përmes komunikimeve të shumta, me tani të dënuarin agjentin rezident të BIA-së, Aleksander Vllajiq, të cilit i ka dërguar informacione të dokumentuara që lidhen me rendin kushtetues, sigurinë institucionale dhe veprimtarinë e brendshme të institucioneve të Republikës së Kosovës”, ka thënë prokurori special, Bekim Kodraliu.

Përveç komunikimeve me të dënuarin për spiunazh, Aleksander Vllajiq, në aktakuzë thuhet se Gjukanoviq ka komunikuar edhe me zyrtarë të tjerë

të BIA-s serbe. Ajo akuzohet se ka ndihmuar edhe në krijimin e një narrative armiqësore ndaj institucioneve të Kosovës.

“Informacione pastaj janë transmetuar te zyrtarët e lartë të BIA-s, përkatësisht Radko Gajtanoviq, përgjegjës i BIA-s për rajonin e Novi-Pazarit në Serbi dhe zyrtarin tjetër Lubisha Bukviq. Me këtë të fundit e pandehura në disa raste është takuar në zyrat e BIA-s në Beograd. Ka ndihmuar një krijimin e një narrative armiqësore ndaj institucioneve të sigurisë, shtetësisë dhe integritetit të Kosovës, përmes këtyre veprimeve të qëllimshme”, ka thënë prokurori Kodraliu.

Predrag Milkoviq, avokat i Gjukanoviqit, ka propozuar që masa

e paraburgimit të së akuzuarës, t’i zëvendësohet me arrest shtëpiak, gjë që është kundërshtuar nga prokurori special, Bekim Kodraliu, me arsyetimin se ende ekzistojnë kushtet për vazhdimin e paraburgimit. E gjyqtari Rrahman Beqiri ka thënë se për këtë propozim do të vendosë pasi të përfundojë seanca. Mbrojtja e Gjukanoviqit ka kërkuar po ashtu 30 ditë afat për mbledhjen e provave shtesë, por trupi gjykues, i udhëhequr nga Beqiri, ka vendosur se 15 ditë janë të mjaftueshme.

Gjukanoviq është arrestuar më 28 shkurt të këtij viti, nën akuzën se ka shpërndarë dokumente dhe informacione të ndjeshme tek Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë e Serbisë.

ZGJEDHJET

- ✓ Kandidatët e PDK-së për kryetarë të komunave ua kushtojnë ditën grave
- ✓ LDK-ja përruron linja të reja transporti në Prishtinë e në Klinë premton “energji të re”
- ✓ AAK-ja premton dritë për qytetin që ndriçon gjithë Kosovën
- ✓ Kurti i bindur se Vetëvendosje e fiton Gjilanin pa balotazh
- ✓ Shahini premton ta reduktojë numrin e qenve endacakë
- ✓ Kupina: Prishtina e së nesërme nis me Lidhjen e Prishtinës

Faqe 4-5